

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6952
E martë, 25 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Diaspora viziton Kuvendin



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK), RAMUSH HARADINAJ, ËSHTË TAKUAR TË HËNËN ME PËRFAQËSUES TË SHOQATAVE TË DALA NGA LUFTA

HARADINAJ: KURTI 'UA NGULI THIKËN PAS SHPINE' ALEATËVE DHE VETERANËVE



Në një bisedim me kategoritë e dala nga lufta, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, "ua ka ngulur thikën pas shpine dy vlerave më sublimë të vendit:

aleatëve ndërkombëtarë dhe kategorive të dala nga lufta". "Nga kjo tryezë u bëhet thirrje të gjithëve që mos të vijë puna që veteranët të cilët kanë rrezikuar jetën për neve, që ata vetë ta mbrojnë të drejtën e tyre. Të

ngrihemi të gjithë që t'i mbrojmë veteranët", ka thënë Haradinaj. Në këtë takim përfaqësuesit e veteranëve kanë bërë me dije se nuk do të protestojnë, por do ta presin vendimin e Gjykatës Kushtetuese

AKTUALE




ARRESTOHET ISH-DREJTORI I POLICISË NË MAL TË ZI F. 2

SVEÇLA DHE BALLA VIZITOJNË PIKËN KUFITARE VËRMICË - MORINË, PREMTOHET ZGJIDHJE PËR MËRGIMTARËT PËR SIGURIME F. 7

KURTI PRET NË TAKIM LAMTUMIRËS AMBASADORIN E NORVEGJISË NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



GËRXHALIU: MUNGESA E DIALOGUT SOCIAL NË KOSOVË DËRGON LIGJIN MBI PAGËN MINIMALE NË KUSHTETUESE F. 8

RITJIA E PAGËS MINIMALE, EKSPERTËT E EKONOMISË THONË SE QEVERIA DUHET T'I NDIHMOJË BIZNESET E VOGLA F. 8

SPORT



LLAPI 'BLINDON' MBROJTJEN ME BEKTESHIN F. 10



BISLIMI: KOSOVA NUK DUHET TË SHPALLË ZGJEDHJE NË VERI PA U HEQUR SANKSIONET NGA BE-ja F. 5

SI KANË NDRYSHUAR TEMPERATURAT NË KOSOVË NDËR VITE? F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Arrestohet ish-drejtori i Policisë në Mal të Zi

PODGORICË, 24 KORRIK - Prokuroria Speciale e Shtetit ka konfirmuar se ish-drejtori i Policisë së Malit të Zi, Vesellin Veloviq, është arrestuar të hënën dhe ndaj tij rëndojnë akuzat për "akte kriminale të krijimit të një organizate kriminale, abuzim me pozitë zyrtare dhe kontrabandë". Me akuzat të njëjta përballen edhe tre persona të tjerë. "Departamenti i Policisë Speciale, me urdhër të Zyrës së Prokurorit Special, i ka privuar nga liria V. V. dhe M. N. dhe ndaj tyre është ngritur padi penale, si dhe ndaj A. M. dhe N. M., të cilët janë në kërkim", është thënë në deklaratën e Prokurorisë. Në të është thënë se zyrtarët policorë i kanë bastisur edhe banesat dhe objektet e tjera në pronësi të të arrestuarve. "Dëshmitë kundër tyre janë mbledhur në bashkëpunim

me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim dhe Sundim të Ligjit - EUROPOL". Mes të tjerash, autoritetet e Malit të Zi kanë paralajmëruar se aktivitetet e tyre në këtë drejtim do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim. Veloviq ka qenë drejtori i Policisë së Malit të Zi në periudhën 2007-2011 dhe prej mesit të vitit 2018 deri në fund të vitit 2020. Në periudhën mes dy mandatave, ai ka qenë këshilltar i ish-presidentit të Malit të Zi, Filip Vujanoviq, për çështje të sigurisë dhe mbrojtjes, dhe në qeverinë e ish-kryeministrit Millo Gjukanoviq, nga viti 2014 ka qenë sekretar i Këshillit Kombëtar të Sigurisë. Prej fundit të vitit 2020, pas ndryshimit të Qeverisë në Mal të Zi, ka qenë këshilltar i Gjukanoviqit për çështje të



sigurisë, deri më 20 maj të këtij viti. Gjukanoviqi i ka humbur zgjedhjet presidenciale në prill të këtij viti. Veloviqi ka pasur funksione të rëndësishme në Policinë e Malit të Zi edhe

para pavarësisë së shtetit. Në periudhën 1995-2005 ai ka qenë komandant i Njësitit Special Kundër-Terrorizmit. Në fund të viteve 1990, gjatë trazirave politike në mes të Gjukanoviqit, atëbotë

kryeministër i Malit të Zi, dhe ish-presidentit të shtetit, Momor Bullatoviq, i cili ka qenë besnik ndaj ish-liderit jugosllav, Slobodan Millosheviq, Veloviqi e ka parandaluar në janar të vitit 1998 një tentim të mbështetësve të Bullatoviqit për ta pushtuar ndërtesën qeveritare. Më vonë, Veloviqi është lidhur me disa afëra në ekonomi, në të cilat ka marrë pjesë policia. Ai është arrestuar për sulm ndaj një zyrtari në protestat e shtatorit të vitit 2021 në Cetinje, teksa është kundërshtuar shugurimi i Mitropolitit Joaniki në Kishn Ortodokse Serbe në atë qytet. Ai është liruar pas dy ditëve në mbajtje dhe, më pas, në maj, Gjykata Supreme në Podgoricë e ka përmbysur vendimin e shkallës së parë për lirimin e Veloviqit.

ShBA-ja dërgon dy nëndetëse në Korenë e Jugut

WASHINGTON, 24 KORRIK - Komanda e Kombeve të Bashkuara në Gadishullin Korean njoftoi se ka filluar komunikimin me Phenianin për ushtarin amerikan që javën e kaluar kaloi kufirin me vrap në drejtim të Koresë së Veriut. Largimi i ushtarit ndodhi në një kohë tensionesh të larta në Gadishullin Korean, ku ritmi i demonstrimit të armëve të Koresë së Veriut dhe stërvitjeve të kombinuara ushtarake të Shteteve të Bashkuara me Korenë Jugore janë shtuar. Seuli njoftoi se një nëndetëse e dytë amerikane ka mbërritur në Korenë e Jugut brenda pak ditësh. Dy nëndetëse amerikane kanë arritur brenda pak ditësh në Gadishullin Korean. E para që mban raketa balistike bërthamore arriti javën e kaluar, ndërsa të hënën arriti një tjetër nëndetëse që funksionon me energji bërthamore. Nëndetësja "USS Annapolis" arriti të hënën në bazën detare



në ishullin jugor të Koresë së Jugut, Jeju, tha marina e Seulit në një konferencë për shtyp, pa dhënë detaje për misionin e saj. "Marina e Koresë së Jugut dhe e ShBA-së planifikojnë ta forcojnë mbrojtjen e përbashkët me mbërritjen e nëndetësës USS Annapolis dhe të kryejnë aktivitete për ta përkujtuar 70-vjetorin e aleancës", tha Jang Do, komandanti i Marinës së Koresë së Jugut.

Nëndetësja amerikane me armë bërthamore "USS Kentucky" arriti në Korenë e Jugut të martën e kaluar. Kjo është hera e parë që një nëndetëse bërthamore amerikane arrin në Gadishullin Korean që nga vitet 1980. Arritja e nëndetësës përkon edhe me nisjen e bisedimeve mes ShBA-së dhe Koresë së Jugut për t'i koordinuar reagimet në rast të një lufte bërthamore me Korenë e Veriut. Koreja e Veriut lëshoi dy

raketa balistike të mërkurën, disa orë pas arritjes së nëndetësës amerikane "USS Kentucky", ndërsa të shtunën lëshoi disa raketa nga anijet e saj. Ndërkaq vazhdojnë shqetësimet për ushtarin amerikan Travis King i cili vrapoi drejt Koresë së Veriut javën e kaluar duke e kaluar kufirin mes dy Koreve. Zëvendëskomandanti i Komandës së OKB-së tha se ka nisur bisedimet me Penianin për

ushtarin amerikan. Gjenerali Andrew Harrison tha se procesi ka nisur nëpërmjet linjave të komunikimit të ngritura në Zonën e Përbashkët të Sigurisë midis Koreve sipas marrëveshjes së armëpushimit që i dha fund luftës mes Koreve në vitet 1950-53. "Nuk dua të spekuloj. Askush nga ne nuk e di se ku do të përfundojë kjo çështje. Unë jam optimist në jetë dhe mbetem optimist, por nuk dua të shtojë diçka më shumë", tha gjenerali Andrew Harrison, nënkomandant i Komandës së Kombeve të Bashkuara. Koreja e Veriut nuk ka bërë asnjë koment për ushtarin amerikan Travis King, i cili të martën e kaluar kaloi kufirin papritur duke shkuar në Korenë e Veriut, ndërkohë që duhej të kthehej në Shtetet e Bashkuara nga Seuli. Vizitat turistike në Zonën e Përbashkët të Sigurisë mes dy Koreve janë pezulluar që nga kalimi i ushtarit amerikan përtej kufirit.

Korfuzi, tjetër ishull grek që lëshon urdhër për evakuim

ATHINË, 24 KORRIK - Korfuzi është kthyer në ishullin e fundit grek që ka lëshuar urdhër për evakuim teksa Greqia po përballen me zjarre pyjore. Në disa fotografi të publikuara në rrjetet sociale është parë ishulli i përfshirë nga flakët. Urdhri në këtë ishull vjen pasi rreth 19 000 persona janë evakuuar nga ishulli tjetër grek

Rodos, që është përfshirë, po ashtu, nga zjarret. Shumë persona janë detyruar të ikin nga hotelet, pasi zjarret kanë vazhduar të përhapen nga qendra e ishullit grek. Greqia ka regjistruar ditët e fundit temperaturë mbi 40 gradë celsius dhe, për pasojë, në disa zona janë përhapur zjarret.

Presidenca greke ka thënë se plani që e hëna të shpallet festë kombëtare tani është anuluar si pasojë e "kushteve të jashtëzakonshme në shtet për shkak të zjarreve". Korfuzi - që gjendet në Detin Jon, në veriperëndim të Greqisë - është destinacion i vizituar shumë nga turistët, kryesisht ata britanikë.



Si kanë ndryshuar temperaturat në Kosovë ndër vite?

PRISHTINË, 24 KORRIK - Mesatarja e temperaturave maksimale gjatë muajit korrik në Kosovë arrin në 31.2 gradë celsius, sipas të dhënave të kompanisë amerikane që ofron parashikim të motit në mbarë botën, Accuweather.

Instituti i Hidrometeorologjisë i Kosovës (IHMK) ka paralajmëruar se ky muaj, bazuar në mesataren e temperaturave maksimale, do të jetë "ndër muajt më të nxehtë për shumë prej viteve të fundit". Të dhënat nga IHMK-ja dhe Accuweather tregojnë se vala e nxehtësisë që ka goditur Evropën ka bërë që korriku i këtij viti të jetë më i nxehti në gjashtë vjetët e fundit. Temperatura mesatare maksimale prej 31.2 gradësh celsius - duke llogaritur edhe parashikimet për pjesën e mbetur të muajit korrik - bën që korriku i këtij viti të jetë më i nxehti në sërë paku gjashtë vjetët e fundit.

Ministria e Shëndetësisë e Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve të kenë kujdes gjatë ditëve në vijim, pasi temperaturat mund të arrijnë deri në 40 gradë celsius. E gjatë këtyre ditëve të fundit shumë qytetarë të Kosovës janë drejtuar në pishina e fontana të ndryshme nëpër vend në përpjekje për t'u freskuar. Këto temperatura vijnë pas dy muajve më të freskët dhe me reshje të shpeshta shiu në Kosovë, të cilat shkaktuan vërshime në disa qytete - me dëme më të mëdha në Pejë. Gjatë periudhës kohore 2020-2023, maji dhe qershori i këtij viti kanë qenë më të ftohtit, ndërsa korriku më i nxehti. Vërshimet në Pejë shkaktuan vdekjen e një nëne dhe fëmijës së saj pesëvjeçar, ndërsa stuhi të ndryshme ua morën jetën shtatë personave javën e



kaluar në Ballkan dhe lanë qindra të tjerë të lënduar. I gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor është goditur nga temperaturat e larta. Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë përballur me temperatura edhe më të larta se në Kosovë. Shkencëtarë të ndryshëm ia kanë atribuuar këtë mot ekstrem fenomenit El Niño, i cili, përveçse kontribuon në ngritjen e

temperaturave në shumë pjesë të botës, edhe rrit rrezikun për të reshura shiu dhe vërshime. IHMK-ja ka parashikuar se temperaturat ekstreme do të vazhdojnë edhe disa ditë, por se ato do të bien nën 30 gradë celsius më 27 dhe 28 korrik. Por, kjo nuk është hera e parë që Kosova është goditur nga valë të tilla të nxehtësisë. Që nga viti 2001 muaji korrik në Kosovë ka qenë në tri raste - në

Si të qëndrojmë të sigurt në mot të nxehtë?

Qendrat për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) në Shtetet e Bashkuara i kanë disa këshilla: Vishni rroba të përshtatshme që janë të lehta dhe të gjera. Qëndroni në vende me kondicionerë sa të keni mundësi. Nëse shtëpia juaj nuk ka kondicionerë, shkoni në qendër tregtare apo në biblioteka publike. Mund ta telefononi edhe Departamentin Lokal Shëndetësor për të parë nëse kanë vende të lira për t'i ikur vapës. Kufizojeni aktivitetin në ambiente të

jashtme apo ndërrojeni orarin kur është më freskët. Pini shumë lëngje dhe mos pini shumë alkool. Qëndroni në hije, përdorni krem kundër diellit me mbrojtës të lartë dhe vendosni kapele me mbulim të gjerë. Keni kujdes që t'u ndihmoni atyre që kanë nevojë, personave të moshuar, atyre që kanë ndonjë sëmundje, apo atyre që jetojnë vetëm. Mos e lini askënd, sidomos foshnjat, fëmijët e vegjël apo kafshët nëpër makina të mbyllura.

Si ndikon moti i nxehtë në trup dhe kush rrezikohet më së shumti?

Dhjetëra miliona njerëz janë duke u përballur me temperatura shumë të larta në gjithë botën. Moti i nxehtë në Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe Azi konsiderohet një prej shembujve se si rrezikohet bota nga ngrohja globale. Temperatura mesatare globale e ka prekur një rekord të ri në javën e parë të korrikut. I nxehti mund të ndikojë te secili, mirëpo disa grupe janë më të cenushme, sikurse të moshuarit dhe foshnjat. Moshat e shtyra dhe personat me sëmundje kronike, sikurse

sëmundje të zemrës, mund ta kenë më të vështirë funksionimin në këto kushte. Diabeti mund ta bëjë trupin që të humbë ujë më shpejt dhe disa komplikime të sëmundjes mund t'i ndryshojnë enët e gjakut dhe aftësinë për të djersitur. Edhe fëmijët janë të cenushtëm.

Teksa trupi bëhet më i nxehtë, nisin të hapen enët e gjakut. Kjo rezulton me tension më të ulët të gjakut dhe e bën punën e zemrës më të vështirë për ta lëvizur gjakun nëpër trup. Diçka e tillë mund të shkaktojë

simptoma të lehta, siç janë kuarjet apo këmbët e ënjtura. Në të njëjtën kohë, djersitja ndikon në humbje të lëngjeve dhe kripës, prandaj edhe ndryshon balanca e tyre në trup. E gjithë kjo, e kombinuar me tension të ulët të gjakut, mund të çojë në dërrmim nga nxehtësia. Disa prej simptomave janë: marramendje, të përziera, të fikët, ngërçe të muskujve, dhimbje koke, djersitje e madhe, lodhje dhe lëkurë e zbehtë. Nëse tensioni i gjakut bie shumë shpejt, rritet rreziku për sulm zemre.

vitet 2007, 2012 dhe 2015 - më i nxehtë sesa këtë vit. Mesatarja e temperaturës maksimale gjatë muajit korrik ka ndjekur një trend të ndryshueshëm gjatë viteve 2001-2023. Megjithatë, që nga viti 2018 kjo mesatare nuk ka rënë nën 28.9 gradë, siç ishte zakonisht para vitit 2011. Megjithatë, këtë herë temperaturat minimale kanë qenë më të larta sesa

zakonisht. Shkaku i këtyre temperaturave të larta qytetarët janë rekomanduar nga IHMK-ja ta kufizojnë ekspozimin ndaj rrezeve të diellit, të pinë ujë sa më shpesh dhe të mos konsumojnë ushqim të yndyrshëm. Kjo ka bërë që, sa iu përket temperaturave minimale mesatare, korriku i këtij viti të jetë i dyti më i nxehti që nga viti 2001.



KRYETARI I ALEANCËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK), RAMUSH HARADINAJ, ËSHTË TAKUAR TË HËNËN ME PËRFAQËSUES TË SHOQATAVE TË DALA NGA LUFTA

Haradinaj: Kurti 'ua nguli thikën pas shpine' aleatëve dhe veteranëve

Në një bisedim me kategoritë e dala nga lufta, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, "ua ka ngulur thikën pas shpine dy vlerave më sublimë të vendit: aleatëve ndërkombëtarë dhe kategorive të dala nga lufta". "Nga kjo tryezë u bëhet thirrje të gjithëve që mos të vijë puna që veteranët të cilët kanë rrezikuar jetën për neve, që ata vetë ta mbrojnë të drejtën e tyre. Të ngrihemi të gjithë që t'i mbrojmë veteranët", ka thënë Haradinaj. Në këtë takim përfaqësuesit e veteranëve kanë bërë me dije se nuk do të protestojnë, por do ta presin vendimin e Gjykatës Kushtetuese

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se ai personalisht do të angazhohet që t'i mbrojë veteranët e UÇK-së, por Haradinaj pohon se e gjithë kjo përkrahje ndaj tyre do të bëhet pa e shkatërruar shtetin. Këto komente ai i bëri pas takimit me përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, shoqatat e të burgosurve politikë, shoqatat e të pagjeturve si dhe ish-udhëheqës të UÇK-së.

Në një konferencë për medie ai ka adresuar sërish kritika për qeverinë, duke shtuar se ua ka ngulur thikën miqve dhe vlerave të luftës. Madje ai u ka bërë

thirrje të gjithëve që të bëhen bashkë në mbrojtje të të drejtave të veteranëve duke iu referuar lënies jashtë nga Ligji për Pagën Minimale. "Veteranët e çmojnë shtetin, e duan Kosovën. I duan institucionet, por edhe institucionet duhet ta duan Kosovën. Nuk do të ishte mirë që veteranët ta mbrojnë vetë të drejtën e vet, por institucionet, në këtë rast qeveria dhe deputetët, duhet t'i mbrojnë veteranët. Unë do ta mbroj të drejtën e veteranëve, por jo duke e shkatërruar shtetin tonë. Sot e kishim një takim, ku mbizotëroj tema e veteranëve, padrejtësia që u është bërë veteranëve. Qëndrimi i të gjithëve ishte për qëndrimet që i kam cilësuar si thikë pas shpine të kësaj qeverie si aleanca me NATO-n, Amerikën dhe vlera e luftës tonë.

Nga kjo tryezë u bëhet thirrje të gjithëve që mos të vijë puna që veteranët të cilët kanë rrezikuar jetën për ne, që ata vetë ta mbrojnë të drejtën e tyre. Të ngrihemi të gjithë që t'i mbrojmë veteranët", ka thënë Haradinaj. Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, ka thënë se do ta presin vendimin e Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për Pagën Minimale, edhe pse kishin paralajmëruar bllokim të Kuvendit.

Jashari në takimin e thirrur nga AAK-ja shtoi se lënia jashtë Ligjit për Pagën Minimale e kësaj kategorie është vendimi më i keq dhe gabim i madh. Madje ai këtë e ka quajtur tradhti dhe keqpërdorim të besimit të qytetarëve. "Vendimet e fundit të kësaj qeverie përmes deputetëve

Haradinaj: Nuk jam unë si Albin Kurti që prej kafeve që i ka pi me serbë, ka shkuar në zyrë të Demaçit

Në takimin me Shoqatat e Dala nga Lufta, Haradinaj ka thënë se është veteran i vërtetë e jo, sipas tij, si Kurti, që "prej kafeve me serbë, ka shkuar në zyrë të Demaçit". "Çdo brez i atyre që kanë bërë sakrificë për liri ndien respekt për pasardhësit, gjithashtu ndihet i fyer kushdo që e fyen sakrificën e kujtdo për liri. Një besimi që ka lindur në sakrificë, që nuk ka qenë i lehtë për t'u fituar e nuk ka qenë i lehtë të mbahet, kjo qeveri i ka futur thikë pas

shpinës. Kurti dhe kjo qeveri i ka ngulur thikë pas shpine sakrificës sonë për liri, kategorive të lirisë. Sjellja e Kurtit ndaj kësaj kategorie është jonjerëzore, joshtetërore dhe jointucionale. Unë jam veteran. Kam emër e mbiemër. Nuk jam Albin Kurti që prej kafeve që i ka pi me serbë, ka shkuar në zyrë të Demaçit e prej aty në Serbi në burg. Nuk jam as Mimoza Kusari. Unë e di a kanë qenë veteranët e vërtetë a jo", ka thënë Haradinaj.

ishin gabim i madh. Qeveria ka bërë tradhti ndaj kësaj kategorie. Mos ta keqpërdorin besimin që ia kanë dhënë qytetarët. Ata që e kanë marrë besimin të punojnë. Ne nuk do të heqim dorë nga qëndrimet e tona. Deri në interpretim të Kushtetueses ne do të presim, edhe pse jemi

prekur keq, sepse është prekur dinjiteti i secilit qytetar", ka thënë Jashari.

Kryetari i Shoqatës "Zëri i Prindërve", Bajram Qerkini, e ka falënderuar Haradinajn pasi, siç ka thënë ai, kreu i AAK-së gjithmonë ka qenë zëri i tyre. Sipas tij, qeveria nuk po merret

Pas 10 viteve Çekia e kalon një marrëveshje të bllokuar me Kosovën, flet ish-kryediplomati Hoxhaj

PRISHTINË, 24 KORRIK - Gati 10 vjet që nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë ndërmjet Kosovës dhe Çekisë, presidenti çek, Petr Pavel, ka nënshkruar ligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshje të pezulluar me Kosovën. Siç njoftuan mediet çeke, Traktati i nënshkruar më 26 nëntor 2013 është i pari i këtij lloji midis dy shteteve. "Marrëveshja do të hyjë në fuqi pasi të shkëmbehen instrumentet e ratifikimit dhe do të zbatohet nga 1 janari i vitit pas hyrjes së tij në fuqi", raportoi "Orbitax".

Në lidhje me këtë marrëveshje të mbetur peng për rreth dhjetë vjet, "Nacionale" ka biseduar me ministrin asokohe të Jashtëm të Kosovës, Enver Hoxhaj, i cili shpjegon edhe arsyen se pse kjo

marrëveshje kishte mbetur e bllokuar. "Kjo është marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, të cilën unë e kam pasur si prioritet ta nënshkruaj me të gjitha vendet evropiane, por edhe me vende të tjera në botë si bazë e rëndësishme për bashkëpunim ekonomik. Në Çeki është bllokuar nga Milos Zeman i cili ndjek politikë pro-Putin dhe kundër pavarësisë së Kosovës dhe i cili nuk e akreditonte as ambasadorin e Kosovës në Pragë", ka thënë Hoxhaj.

Kujtojmë se ish-presidenti çek Milosh Zeman gjatë një vizite në Beograd në shtator të 2019-s deklaronte haptazi se do ta diskutonte me ligjvënësit çek tërheqjen e njohjes së Kosovës. Madje qysh në fillim të mandatit të tij në një intervistë me "The



Economist" ishte shprehur brutalisht se "Kosova është një regjim terrorist i financuar nga narko-mafitë".

Enver Hoxhaj, në dritën e këtyre qëndrimeve skajshmërisht problematike të ish-presidentit çek, na thotë se "përderisa çdo

qeveri çeke ka qenë mbështetëse e pavarësisë së Kosovës, Zemani dhe pararendësi i tij në pozitë ka ndjekur një politikë të vjetër pro-imperializimit rus në Evropën Lindore dhe pro hegjemonisë së Serbisë në Ballkan, si fantazma të së kaluarës!".

Ndërkaq me presidentin e ri të Çekisë, Petr Pavel, Hoxhaj është më se optimist për prospektin e ndërtimit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Prishtinës dhe Pragës. "Me presidentin e ri Petr Pavel ky boshllëk bashkëpunimi institucional është mbushur me qartësi në mbështetje të Kosovës dhe shpresoj që Çekia do të dërgojë në Prishtinë diplomatë me rang të ambasadorit si një emërim i plotë diplomatik!", ka thënë Hoxhaj për "Nacionalen".

Bislimi: Kosova nuk duhet të shpallë zgjedhje në veri pa u hequr sanksionet nga BE-ja

PRISHTINË, 24 KORRIK - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, në një takim me gazetarë në Prishtinë, ka thënë se Kosova nuk duhet të shpallë zgjedhje në veri të vendit pa u hequr masat ndëshkuese të vendosura nga Bashkimi Evropian. Bislimi tha se është në pritje të njoftimit të BE-së për heqjen e sanksioneve pas pajtueshmërisë së arritur në mes të Kosovës dhe BE-së në Bratisllavë dhe tërheqjes së 25 % të forcave policore nga ndërtesat komunale në katër komunat veriore. Edhe pse më herët presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se organizimin e zgjedhjeve e lejon rregullimi ligjor i Kosovës dhe se diçka e tillë mund të bëhet përmes një peticioni të nënshkruar nga 20 për qind e qytetarëve që janë në listën votuese, të cilët mund ta iniciojnë procesin e zgjedhjeve të reja, Bislimi tha se nuk është i sigurt që ekziston një bazë e përshtatshme ligjore për shpalljen e tyre. "Është problem i brendshëm i Kosovës për të cilin nuk ka pajtim se a mjafton udhëzimi administrativ apo duhet ligj", ka thënë Bislimi. Burimet diplomatike nga BE-ja i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se heqja e masave



ndëshkuese që Bashkimi Evropian i ka vendosur Kosovës do të varet nga zbatimi i obligimeve që ka marrë Prishtina dhe hapat e tjerë që priten nga autoritetet në Kosovë për vazhdimin e përpjekjeve për t'i ulur

tensionet në veri. Sipas këtyre burimeve, këto hapa që po ndërmerr Kosova "janë hapa në drejtim të duhur", por në BE presin të shohin edhe hapat e tjerë. "Masat ndaj Kosovës nuk ishin vendosur aq lehtë. Ato janë të kthyeshme dhe nuk do

të zgjasin asnjë ditë më shumë sesa që duhet. Por, për tërheqjen e tyre duhet dëshmi se Kosova po i ndërmerr të gjitha hapat që janë kërkuar nga ajo dhe për shkak të të cilave edhe ishin vendosur këto masa", tha një burim në BE për

Radion Evropa e Lirë.

Masat që po zbaton BE-ja ndaj Kosovës përfshijnë: pezullimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe pezullimin e vizitave dypalëshe, përveç atyre që përqendrohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Masat e tjera përfshijnë edhe ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit) si dhe propozimet e Kosovës në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga bordi më 29 dhe 30 qershor.

Situata në veri të Kosovës është përkeqësuar pasi serbët lokalë në komunat në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë, me asistimin e Policisë së Kosovës, në ndërtesat komunale. Kryetarët i kanë fituar mandatet në zgjedhjet e mbajtura në prill të këtij viti të cilat i kanë bojkotuar serbët.

seriozisht me kërkesat e tyre për çfarë ka adresuar një varg kritikash.

Kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Fadil Shurdhaj, e ka akuzuar Qeverinë e Kosovës për mungesë të përkujdesjes për kategoritë e dala nga lufta, në veçanti invalidët.

Shurdhaj ka thënë se qeveria aktuale e ka ndërprerë edhe komunikimin me organizatën që ai e përfaqëson. Ai ka theksuar se kategoria që ai e përfaqëson nuk është duke kërkuar luks, por vetëm të drejtat bazike, derisa ka shtuar se ekzekutivi po tallet me

kategoritë e dala nga lufta. AAK-ja e ka dërguar javën e kaluar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e përfitimit në lartësi të pagës minimale.

Ndërkaq presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se nuk do ta nënshkruajë Ligjin për Pagën Minimale derisa Gjykata Kushtetuese të marrë vendim për të. Ligji për Pagën Minimale është miratuar në lexim të dytë në Kuvendin e Kosovës më 13 korrik. Ligji parasheh rritjen e

pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht. Mirëpo kundër miratimit të ligjit kanë dalë disa parti opozitare dhe veteranët e luftës, të cilët janë të pakënaqur për mospërfshirjen e tyre në ndryshimet ligjore.

Totaj merr pjesë në hapjen e Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit "PrizrenFest"

PRIZREN, 24 KORRIK - Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka marrë pjesë në hapjen e Festivalit Ndërkombëtar të Teatrit në skena të hapura "PrizrenFest", i cili ka nisur me shfaqjen "Maidan Inferno", një bashkëpunim në

mes të Ukrainës dhe Francës. Ky festival plotëson mozaikun e festivaleve në Prizren, duke sjell shumë publik nga e gjithë bota e duke e futur kështu në hartën artistike qytetin tonë dhe Kosovën. "Falënderoj trupën

teatrore të Ukrainës, që sonte e shfaqti shtetin e vet përtej artit e teatrit dhe u përçoll nga shumë media, 20 nga ta gazetarë ukrainas që aktualisht janë të strehuar në Kosovë dhe veprojnë këtu", ka thënë kryetari Totaj.



Përfundojnë dëgjimet buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitet 2024-2026 në Mitrovicë

MITROVICË, 24 KORRIK - Kanë përfunduar dëgjimet buxhetore me qytetarë të mbajtura në komunën e Mitrovicës. Këtë vit, me vendim të kryetarit, është formuar edhe grupi punues për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 2024-2026, të cilët kanë hartuar orarin e dëgjimeve buxhetore për planifikim të buxhetit për vitet 2024-2026. Në komunën e Mitrovicës janë mbajtur nëntë

dëgjime buxhetore, katër prej tyre janë mbajtur në fshatrat Shupkocv, Kçiq, Rahovë dhe Koshtovë, ndërsa pesë prej tyre janë mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal. Në këto takime kanë marrë pjesë drejtorë të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë. Fillimisht në këto dëgjime përfaqësuesit

komunalë kanë shpalosur synimet e komunës për buxhetin e vitit 2024 dhe planifikimin për vitet 2025 dhe 2026, dhe kanë treguar për projektet që do të zhvillohen në lokalitetet e tyre, ndërsa të gjithë të pranishmit janë pajisur me materialet informuese të projekteve kapitale që janë planifikuar të realizohen gjatë viteve në vazhdim në lokalitetet e tyre.

Promovohet libri i tretë i monografisë "Kronikë nëpër stuhi" i Sabahajdin Cenës

RAHOVEC, 24 KORRIK - Në prani të familjarëve, strukturave të pushtetit lokal, ish-ushtarëve të UÇK-së dhe dashamirësve të librit, në sallën e Kuvendit të Komunës së Rahovecit është bërë promovimi i monografisë "Kronikë nëpër stuhi", e autorit dr. Sabahajdin Cena. Për vlerat e librit folën Erseka Cana, prof. dr. Besim Muhadri, si dhe redaktori i librit Qemajl Krasniqi. Në emër të familjes Cena të pranishmit i përshëndeti i biri i profesorit Samedin Cena. Folësit potencuan faktin se libri i tretë i serisë monografike "Kronikë

nëpër stuhi", që botohet pas vdekjes së autorit, përfshin dëshmorët e UÇK-së të rënë në periudhën korrik - gusht - shtator. Po në këtë libër janë përshkruar edhe datëlindjet dhe dita e përjetësimit e shumë dëshmorëve anekënd Kosovës të cilët kanë rënë në këtë periudhë kohore. Për botimin e librit u përkujdesën komuna e Rahovecit dhe OVL e UÇK-së, dega në Rahovec, si dhe bashkëluftëtarët e profesorit të ndjerë Sabahajdin Cena. Pritet që deri në fund të këtij viti të përmbyllet botimi i katërt i kësaj monografie.



Stuhia shkaktoi dëme të konsiderueshme në Malishevë

MALISHEVË, 24 KORRIK - Stuhia e shoqëruar me breshër të dielën ka shkakuar dëme të konsiderueshme në një pjesë të komunës së Malishevës. Si pasojë e stuhisë, janë dëmtuar në masë të madhe kulturat bujqësore, serrat dhe të mirat e tjera materiale por, fatbardhësisht, pa dëme në njerëz. Për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Sylë Dukolli, me kërkesën edhe të kryetarit të komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, e ka vizituar fshatin Pllloqicë, ku edhe janë shënuar dëmet më të mëdha nga stuhia.



Në emër të kryetarit Kastrati, drejtori Dukolli ka shprehur keqardhjen për dëmet që u janë shkakuar bujqve dhe ka thënë se "do të jemi gjithmonë pranë qytetarëve, në veçanti pranë bujqve e fermerëve të cilët janë dëmtuar rëndë gjatë ditës së djeshme". Drejtori Dukolli, bashkë me zyrtarët përgjegjës të drejtorisë për bujqësi, i kanë vizituar disa nga fermerët e dëmtuar. Familjen e Shkumbin Malokut, të cilit breshëri e stuhia ia kanë dëmtuar rreth 80 ari serrë dhe Hashim Malokun, të cilit gjithashtu stuhia ia ka

dëmtuar në tërësi serrën. Përveç dëmeve të rënda në serrat e tyre, në tokë shihej breshëri i rënë gjatë ditës së djeshme, e që ende nuk është shkrirë dhe, krahas serrave dhe pemëve, breshëri e stuhia i ka dëmtuar në masë të madhe edhe kulturat e tjera, grurin e pakorrur dhe misrin. Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Sylë Dukolli, ka bërë me dije se është aktivizuar komisioni i cili do ta bëjë vlerësimin e dëmeve varësisht nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të cilët e kanë njoftuar komunën për dëmet në të mbjellat e tyre.

70 për qind e punimeve kanë përfunduar në autostradën Gjilan - Prishtinë

GJILAN, 24 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti, zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi dhe kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, kanë vizituar punimet të cilat po realizohen në tri lotet e autostradës Gjilan - Prishtinë.

U bë me dije se 70 për qind e punimeve kanë përfunduar në autostradën Gjilan - Prishtinë. Gjatë vizitës në lotin e parë me gjatësi mbi 4.8 km, lotin e dytë 2.5 km dhe lotin e tretë 2.2 km, panë nga afër punën që po bëhet për nënkalinimin ndërmjet lotit të dytë dhe lotit të tretë që në

këtë mënyrë do të mundësojë edhe lidhjen e fshatrave Smallushë dhe Sllavi që, gjithashtu, të kenë qasje. Krahas dinamikës së projektit, së bashku me nivelin qendror po i kushtojmë rëndësi të veçantë cilësisë së punimeve infrastrukturore, ndriçimit dhe sinjalistikës.



Fillon stërvitja ushtarake bazë për rekrutë

PRISHTINË, 24 KORRIK - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka njoftuar se kanë filluar stërvitjet ushtarake bazë për rekrutë. Në njoftimin e bërë për medie thuhet se plan-programi zgjatë nëntë javë dhe janë të përfshirë 316 rekrutë. "Komanda e

Doktrinës dhe Stërvitjes do të kujdeset për trajnim dhe zhvillim të karakterit luftarak për rekrutet e rinj. Atdhedashuria dhe profesionalizmi janë pjesë përbërëse e plan-programit 9 javor. Përgatitja për shërbim ndaj vendit për

316 rekrutët ka filluar sot", thuhet në njoftim. FSK-ja shton se "e ardhmja fillon këtu". FSK po vazhdon të pajiset edhe me armatim. Para disa ditëve ka paraqitur dronët e blerë nga shteti turk.



Sveçla dhe Balla vizitojnë pikën kufitare Vërmicë - Morinë, premtohet zgjidhje për mërgimtarët për sigurime

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Taulant Balla, kanë vizituar pikën e përbashkët të kalimit kufitar Vërmicë - Morinë. Ministri i Punëve të Brendshme i Shqipërisë, Taulant Balla, ka thënë se gjatë takimit kanë biseduar se si të gjendet një zgjidhje lidhur me sigurimin që bëjnë mërgimtarët në këtë pikë kufitare, me ç'rast po krijohet kolona. "Është gjë e mirë që ka shkëmbim të madh mes dy anëve të kufirit. Arsyeja e këtij takimi ka qenë një kërkesë e imja. Kemi shumë marrëveshje të firmosura që duhet të zbatohen, por konkretisht ka një rritje të numrit të mërgimtarëve dhe udhëtarë të cilët udhëtojnë nga Shqipëria në Kosovë dhe për

shkak se duhet të pajisen me sigurim kjo merr kohë të caktuar. Shqetësimi im është që sa kohë mërgimtarët bëjnë me orë të vijnë dhe prapë presin në kufi. Duhet gjetur një mundësi që sigurimi mos të bëhet në kufi", ka thënë ai.

Balla u shpreh i bindur se ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, do të gjejë një zgjidhje. Ndërkaq, ministri Sveçla para medieve ka theksuar se do të gjejnë një zgjidhje që mërgimtarëve t'u ndihmojnë. "Kemi shumë marrëveshje të nënshkruara, po punojmë që marrëveshjet të implementohen. Nuk kemi shtetas të Kosovës dhe Shqipërisë që presin në radhë, problem është me mërgimtarët që vijnë për pushime. Ne kemi vullnetin më të mirë që mërgatave tona t'u shërbejmë shpejt. Po mendojmë disa variante se si t'i kalojmë këto vështirësi", ka deklaruar Sveçla.



Kurti pret në takim lamtumirës ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë



PRISHTINË, 24 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti së bashku me zëvendëskryeministrin e parë, Besnik Bislimi, ka pritur të hënën në takim lamtumirës ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl. Të dy falënderuan ambasadorin Grondahl për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes të dy vendeve si dhe për angazhimin dhe përkushtimin e tij në këtë drejtim, duke i uruar atij suksese në angazhimet dhe përgjegjësitë e radhës. Krahas takimit në

zyrën e tij të pritjeve, kryeministri, për nder të ambasadorit Grondahl, shtroi edhe një mëngjes të përbashkët edhe me këshilltarët e angazhuar në qeveri nëpërmjet mbështetjes së ambasadës norvegjeze. Kryeministri shprehu mirënjohjen e thellë të tij për kontributin e shtetit norvegjez dhe ritheksoi se Norvegjia është dhe mbetet partnerja jonë e rëndësishme me të cilën ndajmë vlera, bindje dhe pikëpamje për sigurinë dhe paqen në rajon e më gjerë.

Diaspora viziton Kuvendin

PRISHTINË, 24 KORRIK - Kuvendi i Kosovës ka nisur të hënën aktivitetin "Bashkatdhetarët në Kuvend". Me këtë rast dyert e Kuvendit janë hapur për të gjithë ata bashkatdhetarë të cilët janë

të interesuar të shohin për së afërmi punën në këtë institucion, gjithashtu të takohen edhe me deputetë. Gjatë ditës së hënë është vërejtur interesim i madh i bashkatdhetarëve të cilët

kanë ardhur për të parë nga afër punën edhe aktivitetet që zhvillohen në Kuvend. Me këtë rast ata kanë pasur mundësinë ta shohin edhe sallën ku mbahen seancat plenare. Madje disa prej tyre

kanë provuar edhe ndjesinë sesi është të ulësh në ulësen e kryeparlamentarit Glauk Konjufca dhe në atë të kryeministrit Albin Kurti, gjithashtu edhe në ulëset e deputetëve.



Rritja e pagës minimale, ekspertët e ekonomisë thonë se qeveria duhet t'i ndihmojë bizneset e vogla

PRISHTINË, 24 KORRIK - Rritja e pagës minimale në vlerë prej 264 eurove po konsiderohet të jetë e dëmshme për bizneset e vogla. Kështu po vlerësojnë ekspertët e ekonomisë, të cilët bëjnë thirrje që qeveria t'i ndihmojë mikrobizneset qoftë me subvencione të qirasë apo në forma të ndryshme në mënyrë që të mos falimentojnë. Kuvendi i Kosovës pa opozitën, para 10 ditësh ka miratuar Ligjin për Pagën Minimale. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se në Kosovë janë 80 985 persona që paguhen më pak se 264 euro në muaj. Sipas tij, janë punëtorët e mirëmbajtjes, sigurimit fizik, arkëtarë, ndërtimtarë.

Megjithatë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës të premtën e dërgoi në Gjykatë Kushtetuese Ligjin për Pagën Minimale. Ekspertët e ekonomisë kërkojnë nga qeveria të ndërmarrë hapa të nevojshëm në këtë drejtim në mënyrë që të parandalohet rritja e informalitetit.

Njohësi i ekonomisë, Besnik Avdija, thotë për KosovaPress se disa nga bizneset e vogla e kanë problem t'i përmbahen këtij kriteri. Ai thotë se shumica e bizneseve të vogla do të falimentojnë. "Në rast se do të bëhet obligative që do të kenë një pagë fikse 250, apo çfarëdo vlere për këto biznese, do të dëmtohen në masë të madhe për shkak se ato

fillimisht duhet t'i mbushin obligimet ndaj punëtorëve, pastaj ta krijojnë profitin e tyre. Në mënyrë që të bëhet kjo zgjidhje, duhet t'i rritin çmimet e shërbimeve dhe produkteve që nuk mund të jenë konkurrenca në treg, pastaj tregu gradualisht i detyron që ata t'ia vendosin drynin ndërmarrjes. Kjo për shkak se ndërmarrjet e vogla dhe mikro ndërmarrjet e kanë vështirësinë e qarkullimit të kesh-it dhe vështirësinë e kapitalit dhe aseteve të tjera financiare të cilat atyre u pamundësojnë që t'u përmbahen një kriteri të tillë për të vendosur një pagë minimale për punëtorët e tyre 250 euro", thotë Avdija.

Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, thotë se rritja e pagës minimale do t'i dëmtojë ndërmarrjet e vogla. Sipas Rafunës, para se të silltet ligji është dashur të bëhet një vlerësim se sa do të ndikojë rritja e pagës minimale të këto biznese. "Para se të silltet ligji ishte dashur me qenë një studim, një vlerësim se sa do të ndikojë rritja e pagës minimale, sidomos te bizneset e vogla që fillojnë punën. Por, ne edhe më herët e kemi ngritur zërin që bizneset e vogla të ndihmohen në një periudhë të caktuar kohore derisa të stabilizohen pak. Duhet me qenë shumë të kujdesshëm,



në momentin që fillon të implementohet ligji që mos të dëmtohet asnjë biznes, duke përfshirë edhe ato biznese që sapo kanë filluar punën", shprehet ai.

Rafuna shton se ka nevojë që të ndihmohen bizneset e vogla në mënyrë që të mos pësojnë ndonjë dëmtim nga ana e pagës minimale. Në këtë drejtim, ai thotë se shteti duhet t'i ndihmojë këto biznese me politika fiskale.

Ndërsa hulumtuesi nga Riinvest, Visar Vokri, potencon se rritja e pagës

minimale mund të ndikojë në rritjen e informalitetit të punëtorët. "Kjo pagë minimale mund të ndikojë në rritjen e informalitetit për shkak se kemi pasur një numër të bizneseve që kanë deklaruar ndoshta pagën e punëtorëve deri në nivel të pagës minimale, ndërsa pjesën tjetër ua kanë kompensuar përmes kanaleve joformale. Pra, në këtë kontekst konsideroj se qeveria tani duhet të jetë më e kujdesshme dhe të fokusohet në masat që kanë për qëllim

uljen e informalitetit. Pra, në rritjen e kapaciteteve të inspektoratit të punës, në mënyrë që kësaj ta parandalojë rritjen e mëtutjeshme të informalitetit si rezultat i rritjes së pagës minimale", thotë Vokri.

Përndryshe, me 60 vota për dhe një abstenim, para 10 ditësh është miratuar Ligji për Pagën Minimale. Ky ligj parasheh që paga minimale të bëhet në vlerë 264 euro, ndërsa në votim nuk është mbështetur asnjë amendament.

Gërxhaliu: Mungesa e dialogut social në Kosovë e dërgon Ligjin mbi Pagën Minimale në Kushtetuese

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se mungesa e dialogut social në Kosovë e ka dërguar Ligjin mbi Pagën Minimale në Gjykatën Kushtetuese. Gërxhaliu ka thënë se Kosova është para sfidave të shumta të natyrës politike, ekonomike, sociale dhe integruese dhe, sipas tij, dëmi më i madh që po i bëhet Kosovës është fakti se shumë ligje të miratuara në Kuvendin e Kosovës po përfundojnë në Gjykatën Kushtetuese, që vërtet thotë se po e dëmtojnë imazhin e Kosovës. "Sa i përket Ligjit për Pagën Minimale kemi paralajmëruar se ka parregullsi. Pra, ka një mungesë të dialogut të mirëfilltë publiko-privat, në veçanti ka një mungesë sa i përket dialogut social dhe në këtë drejtim është pritur që do të ketë reagime të ndryshme ngaqë ky ligj bie ndesh me Ligjin mbi Pagën në Administratë. Ju e dini se në



administratë kemi koficent 2. Një koficent është 105 euro dhe kemi pagë 210 euro. Në

anën tjetër është paraparë që të kemi pagë minimale 264 euro. Dhe ky është

kundërshtimi i parë", thotë Gërxhaliu, duke shtuar se aty ku mungon dialogu adresa

duhet të jetë Gjykata Kushtetuese. "Në këtë drejtim po besoj se mungon shumë më tepër një elaborim pse 264 paga minimale apo më e madhe dhe po mungon një analizë e mirëfilltë për të parë se sa janë pagat në nivel rajonal. Në qoftë se i shihni vendet e Ballkanit, ka vërtet një laramani sa iu përket pagave. Në këtë drejtim duhet të jetë fokus edhe orientimi i Kosovës sa i përket përcaktimit të nivelit të pagës minimale. Definitivisht kostoja më e madhe po paguhet në mungesë të dialogut, një arrogancë dhe një distancë e pushtetit. Dhe e gjithë kjo po sjell pakënaqësi te qytetarët. Çdo ditë kemi revolta dhe nuk ka armë tjetër për t'i minimizuar këto tensione të krijuara në Kosovë sa iu përket ligjeve, implementimit të tyre, pagës minimale pa një dialog të mirëfilltë që, për fat të keq, Kosovës është duke i munguar", është shprehur Gërxhaliu.

UNË DHE BABAI

Nga: Pär LAGERKVIST
(fitues i Çmimit Nobel për
Letërsi më 1951)
Përktheu nga suedishtja:
Qerim RAQI

Kur isha rreth dhjetë vjeç, më kujtohet, babai më kapi për dore një të diel pasdite dhe dolëm në pyll për ta dëgjuar këngën e zogjve. U përshëndetëm me nënën, e cila duhej të qëndronte në shtëpi për ta gatuar darkën, prandaj nuk na u bashkua. Dielli po shkëlqente ngrohtë dhe ne ishim në rrugë të mbarë. Nuk e morëm aq solemnisht këtë me këngën e zogjve, sikur diçka veçanërisht e këndshme apo e çuditshme, ne ishim njerëz të arsyeshëm, si babai, ashtu edhe unë, të edukuar dhe të mësuar me natyrën. Kjo nuk bënte ndonjë bujë të madhe për ne. Ishte vetëm sepse ishte e diel pasdite dhe babai ishte i lirë. Po ecnim në linjën hekurudhore, ku askush tjetër nuk lejohej të shkonte, por babai ishte mësuar me rrugën pranë hekurudhës dhe e zotëronte atë. Në këtë mënyrë edhe ne u futëm në pyll. Nuk u desh të bënim asnjë kthesë. Së shpejti filloi edhe kënga e shpendëve dhe gjithçka tjetër; cicërima brenda shkurreve të fokave dhe zogjve këngëtarë, harabelave dhe mëllenjave, gjithë zhurma e tyre që të rrethon sapo hyni në pyll. Toka ishte e trashë me lulebore, mëshkënat tani kishin bleruar dhe bredhat ishin lëshuar lastarë të freskët. Vinte erë nga të gjitha anët dhe skutat. Në anën e poshtme shtrihej fundi i pyllit që avullonte nga dielli sipër. Kudo ku kishte jetë dhe zhurmë, nga vrimat e tyre fluturonin gjerëzat, mushkonjat vërshonin nga qielli dhe nga shkurret zogjtë lëshoheshin si fishekë për t'i kapur dhe zhyteshin përsëri shpejt. Papritur erdhi një tren duke zhurmuar dhe ne zbritëm në argjinaturë. Babai e përshëndeti lokomotivistin me dy gishta ngritur mbi kapelë, edhe lokomotivisti e përshëndeti babanë me dorë. E tëra ndodhte shpejt. Më pas u nisëm drejt shinave që ishin djersitur në katranin e tyre nën rrezet e diellit. Mbante erë gjithfarë, vaj vagonësh dhe lule bajame, katrani dhe shqope dhe gjithçka tjetër. Ne bëmë hapa të mëdhenj në hekurudhë dhe jo në zhavorr, që ishte i ashpër për të ecur dhe na i griste këpucët. Binarët shkëlqenin në diell. Në të dyja anët e linjës kishte shtylla të telefonit që këndonin derisa kalonim pranë tyre. Po, ishte një ditë e bukur. Qielli ishte mjaft i kthjellët, nuk dukej asnjë re, as nuk mund të kishte ndonjë re në këtë ditë, sipas asaj që tha babai. Pas ca çastesh ne erdhëm te një arë me tërshëre në të djathtë të linjës, ku një bujk që e njihnim kishte një luadh. Tërshëra




ishite e dundur dhe kallinjë ishin rritur në mënyrë të barabartë. Babai i largonte me dorë dhe dukej se ishte i kënaqur. Thjesht nuk kuptoja shumë gjëra nga këto, sepse kam lindur në qytet. Kështu ne erdhëm tek ura mbi një përrua ku zakonisht nuk ka shumë ujë, por tani rrjedha ishte e plotë. I mbanim dorën njëri-tjetrit që të mos binim mes binarëve. Më pas nuk kaloi shumë kohë para se të arrinim në shtëpizën e rojeve, e cila është tërësisht e mbuluar me gjelbërim, me mollë dhe shkurre. Aty hymë dhe vizituam. Na qerasën me qumësht. I pamë derrat e tyre, pulat dhe pemët në lulëzim, pastaj e vazhduam rrugën tonë. Ne donim të shkonim te përroi i madh, sepse ishte më i bukur se kudo tjetër, kishte diçka të veçantë, sepse atje më lart në fshat kalonte kah shtëpia e fëmijërisë së babait tim. Nuk na pëlqente të ktheheshim derisa arrinim deri këtu. Madje edhe sot mbërritëm këtu pas një shëtitjeje të mirë. Ishte afër stacionit tjetër, por nuk shkuam deri aty. Babi vetëm donte të sigurohej që semafori ishte mirë. Ai i mendonte të gjitha. Ndalua buzë përroit. Rrjedha zhurmonte miqësisht me rrezet e diellit. Përgjatë brigjeve varej pylli i harlisur gjetherënës dhe reflektohej në ujin e levës. Gjithçka ishte e ndritshme dhe e freskët këtu. Nga liqenet e vegjël më lart vinte një erë e vogël. Ne zbritëm nga shpati dhe ecëm pak përgjatë bregut. Babai tregoi vendet ku kishte qëndruar më parë. Këtu ishte ulur si çun, në shkëmbinj, duke pritur me purtekë gjithë ditën. Shpesh nuk kishte ardhur asnjë gjallesë,

por kishte qenë një realitet i bekuar. Tani ai nuk kishte kohë. Kështu që ne shkonim përreth duke fërshëllirë për një kohë të mirë nëpër vijën bregdetare, nxirnim copa lëvoresh të halorëve që rryma i merrte me vete dhe hidhnim guralecë në ujë për të parë se kush guante më larg. Ne për nga natyra, si babai ashtu edhe unë, ishim të lumtur dhe të hareshëm. Më në fund, u lodhëm dhe menduam se kishim qëndruar mjaft aty dhe u nisëm për në shtëpi. Pastaj filloi të errësohej. Pylli kishte ndryshuar. Nuk ishte ende errësirë, por nxituam. Nëna duhet të ketë qenë e shqetësuar derisa na priste për të ngrënë. Ajo gjithmonë kishte frikë se diçka do të ndodhte. Por, për ne ishte një ditë e mrekullueshme. Asgjë nuk na ndodhi. U kënaqëm me gjithçka. Po errësohej edhe më. Pemët ishin shumë të çuditshme. Ato qëndronin dhe i bindeshin çdo hapi që hidhnim, sikur të mos dinin se kush ishim. Një pemë aty kishte një xixëllonjë brenda trungut. Qëndronte duke na i ngulur sytë poshtë në errësirë. Unë i shtrëngova dorën babait, por ai nuk e pa atë shkëlqim të çuditshëm, vetëm vazhdoi të ecte. Ndërkohë arritëm tek ura mbi përrua. Nga thellësia aty dëgjohej zhurma e përroit. E frikshme, që sikur do të hapej një humnerë poshtë nesh. Shkelnim me kujdes traversat, duke ia mbajtur njëri-tjetrit fort dorën që të mos rrëzoheshim. Unë mendova se babi do të më mbante në shpinë, por nuk tha asgjë, mbase donte që unë të isha si ai dhe të mos mendoja se kishte ndonjë rrezik.

Vazhduam. Babai kalonte urën aq i qetë, me hapa të sigurt, në errësirë, i qëndrueshëm, pa folur, mendonte me vete. Nuk mund ta kuptoja se si mund të ishte kaq i qetë kur ishte aq errët. Shikoja përreth i frikësuar. Kudo mbretëronte vetëm errësirë. Mezi guxoja të merrja frymë thellë, sepse atëherë mund ta fusja brenda meje errësirën dhe kjo ishte e rrezikshme. Mendoja se së shpejti do të vdisja. Më kujtohet mirë se këtë e besoja në atë kohë. Argjinatura zbriste pjerrtas, si në humnerat e zeza të natës. Shtyllat e telefonit ngriheshin fantazma deri në qiell, gjëmonin lehtë brenda tyre, sikur dikush të fliste thellë në tokë. Plisat e bardhë prej porcelani qëndronin tmerrsisht të strukur dhe i bindeshin kësaj. Gjithçka ishte e tmerrshme. Asgjë nuk ishte e vërtetë. Gjithçka ishte si një mrekulli. Iu afrova babait dhe i pëshpërita: –Babi, pse është kaq tmerrshëm në errësirë? – Jo, biri im i dashur, errësira nuk është e tmerrshme, tha dhe ma shtrëngoi dorën. – Po baba, është. – Jo bir, nuk është mirë të mendosh kështu. Ne e dimë se ekziston Zoti. Ndihejsha kaq i vetmuar, i braktisur. Ishte shumë e çuditshme se vetëm unë kisha frikë, jo babai. Nuk mendonim njësoj. Dhe e çuditshme ishte se atë që e tha babai nuk më ndihmoi, kështu që nuk duhej të kisha më frikë. As ajo që tha për Zotin nuk më ndihmoi. Edhe unë mendoj se ishte e tmerrshme. Ishte e tmerrshme që ai ishte kudo në errësirë, poshtë trenit, në shtyllat e telefonit që gjëmonin – me siguri ishte ai – kudo. Megjithatë, nuk mund ta shihje

kurrë. Ecnim në heshtje. Secili mendonte për të vetën. Zemra ime tkurrej sikur errësira të kishte hyrë brenda saj dhe ka filluar ta përqafoje. Pastaj, kur ishim në një kthesë, papritmas dëgjuam një bubullimë të madhe pas nesh! Ne u befasuam nga mendimet tona. Babi më tërhoqi poshtë argjinaturës, poshtë në humnerë, më mbajti atje. Më pas kaloi treni. Një tren i zi kaloi me shpejtësi marramendëse. Çfarë ishte ky tren. Nuk duhej të kishte tren tani. Shikua të frikësuar njëri-tjetrin. Zjarri u ndez në lokomotivën e madhe ku hidhnim qymyr me lopata. Shkëndijat gjëmuan egërsisht nëpër natë. Ishte e tmerrshme. Shoferi qëndronte aty i zbehtë, i palëvizshëm, me tipare si të ngurtësuar, i ndriçuar nga zjarri. Babai nuk e dinte se kush ishte, vetëm shikonte përpara, sikur po shkonte brenda errësirës, e cila nuk kishte fund. I ndjekur, i gulçuar nga ankthi, unë qëndrova duke vrojtuar pamjen e egër. Imazhin e përpiu nata. Babai më mori në pistë, nxituam për në shtëpi. Më tha: – E çuditshme çfarë lloj treni ishte! Nuk e njoha shoferin. Pastaj eci në heshtje. Unë po dridhesha i tëri. Kjo e tëra ishte bërë për mua, për dëshirën time. E mora me mend se çfarë do të thoshte. Ishte ankthi që do të vinte, tërë e panjohura, ajo për të cilën babai nuk dinte asgjë, nga e cila nuk do të mund të më mbronte. Kështu do të ishte kjo botë për mua, kjo jetë, jo si e babait, ku gjithçka ishte e sigurt dhe e njohur. Nuk ishte një botë e vërtetë, një jetë e vërtetë. Vetëm depërtonte djegëshëm brenda errësirë që nuk kishte fund. /Revista "Akademia"/Telegrafi/

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Liga e Konferencës, klubet shqiptare i mësojnë kundërshtarët e mundshëm në rrethin e tretë



“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 KORRIK - Tri klubet e Kosovës, Ballkani, Drita dhe Dukagjini, që ende janë pjesë e garave evropiane, kanë mësuar kundërshtarët e mundshëm në rrethin e tretë. Të hënën është bërë tërheqja e shortit për raundin e tretë kualifikues në Ligën e Konferencës. Në raundin e dytë kualifikues Ballkani do të përballet me Larnen, Drita me Viktoria Plzenin, kurse Dukagjini me Rijekën. Kampionët e Ballkanit nëse e kalojnë Larnen do të

përballet me skuadrën nga Gjibraltari, Lincoln Red Imps, kurse nënkampionët e Dritës takohen me fituesin nga ndeshja Gzira United FC (Malta) - F91 Diddeleng (Luksemburg). Befasia e madhe e kësaj gare, Dukagjini i Klinës, nëse kalon në raundin e dytë, do të takohet me fituesin nga ndeshja B36 Torshvan (Ishujt Faroe) - Haverford County AFC (Uells). Ndeshjet e para të këtij raundi do të zhvillohen më 10 gusht, kurse të dytat ose të kthimit më 17 gusht. Të hënën kundërshtarët e mundshëm të

rrethit të tretë i kanë mësuar edhe dy skuadrat nga Shqipëria, Partizani dhe Tirana. Nëse Partizani arrin të kualifikohet ndaj Atletik Eskaldes, atëherë do të përballet me skuadrën e kualifikuar nga përballja Tre Penne - Valmeira. Në anën tjetër, nëse Tirana do të arrijë të kualifikohet ndaj Beshiktashit, atëherë bardheblutë do të ndeshen ndaj të kualifikuarit në ndeshjen Zeljeznicar dhe Neftçi PFK. Ndërsa Struga e Maqedonisë, në rast kualifikimi, do të përballet me The New Saints ose Swift Hesper.

Llapi ‘blindon’ mbrojtjen me Bekteshin

PODUJEVË, 24 KORRIK - Mbrojtësi Leotrim Bekteshi është futbollisti më i ri i skuadrës së Llapit. Ai është paraqitur të hënën, ndërsa ka nënshkruar marrëveshje njëvjeçare me klubin që drejtohet nga Tahir Batatina. “Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë marrëveshjen e

arritur me qendërmbrojtësin Leotrim Bekteshi. Në prani të Drejtorit Sportiv, Mentor Zhdrella, qendërmbrojtësi mitrovicas ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi. Përvoja dhe stabiliteti i tij në mbrojtje padyshim se do të jenë ndihmesë e madhe për

ekipin tonë për t’i arritur objektivat që kemi në edicionin e ri”, thuhet në njoftimin e Llapit. Bekteshi skuadrës së re do t’i bashkohet menjëherë me ekipin në përgatitjet parasezonale për edicionin e ri të Superligës që fillon në muajin gusht.

SHKURT

Shkëlzen Lushtaku vazhdon kontratën me Drenicën

Futbollisti i njohur Shkëlzen Lushtaku ka vazhduar kontratën me Drenicën e Skenderajt. Kapiteni do të jetë pjesë e skuadrës kuqezi edhe në Ligën e Parë. “Kapiteni i skuadrës ka vazhduar të mbetet besnik ndaj klubit tonë dhe ka rinovuar kontratën me klubin edhe për një vit. Shkëlzen Lushtaku do të vazhdojë t’i mbrojë ngjyrat kuq e zi edhe për edicionin 2023/2024. Klubi vazhdon punën intensive për kompletimin e skuadrës dhe në vijim do të njoftoheni edhe për përforcimet e para të ekipit”, thuhet në njoftimin e Drenicës.

Hapet afati kalimtar në basketboll

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) njofton se nga dita e hënën është hapur afati kalimtar në basketboll. Afati do të zgjasë deri më 4 gusht për lojtarët/et vendorë/e dhe të huaj/a. Edicioni i ri pritet të jetë mjaft interesant, ku skuadrat vetëm sa kanë filluar përforcimet, varësisht nga synimet që kanë.

Elisa Mulaj bën hapin e madh në karrierë, i bashkohet ekipit të parë të Akerit

Reprezentuesja e Kosovës në hendboll, Elisa Mulaj, ka bërë hap shumë të rëndësishëm në karrierë. Ajo në edicionin e ri do të luajë për Akerin në elitën e Norvegjisë. Norvegjia ka njërin prej kampionateve më cilësorë në botë, ndërsa pjesë e tij tashmë do të jetë edhe Elisa. Aloja 20-vjeçare është promovuar nga ekipi i të rejave në ekipin senior të Akerit. Promovimin e ka bërë me dy lojtare të tjera. Elisa është shprehur e lumtur që do të luaj në elitën norvegjeze, ndërsa është e përkushtuar të punoj edhe më shumë për ngritje të mëtejme. Elisa dhe motra e saj, Melisa Mulaj, ka shumë vite që paraqiten për ekipet kombëtare të Kosovës. Prej tyre presim kontribut edhe më të madh në të ardhmen.

Veteranët e Kosovës, fitues të trofeut “Fadil Vokrri”

Veteranët e Përfaqësueses së Kosovës e kanë fituar trofeun “Fadil Vokrri”, pasi në turneun tradicional për nder të ditëlindjes së legjendës së futbollit të Kosovës kanë shënuar fitore në përballje me veteranët e Kombëtares së Maqedonisë së Veriut, me rezultat 2-1. Golat për Kosovën i shënuan Sheremet Isufi në pjesën e parë dhe Robert Gjeraj në pjesën e dytë. Ndërkaq, golin e vetëm për mysafirët e realizoi Artim Shaqiri në fund të ndeshjes. Paraprakisht u zhvillua ndeshja ndërmjet veteranëve të KF Llapit dhe veteranëve të KF Prishtina, skuadra në të cilat ka luajtur Fadil Vokrri, ndeshje e cila u mbyll baras 3-3.



Luiza Gega arrin atë që nuk e ka arritur askush më parë

TIRANË, 24 KORRIK - Luiza Gega ka vazhduar rekordet. Kampionia e Evropës u bë e para atlete që arrin të marrë tri medalje të arta në një Kampionat Ballkanik. Askush më parë nuk ia kishte dalë. Treshen e të artave Gega e plotësoi të dielën me triumfin

në garën e 5 000 metrave, ku po përpiqet të përshtatet gjithnjë e më shumë, dhe ku ka ambicie të mëdha në të ardhmen. Atletja shqiptare ia doli të triumfonte në turneun që po zhvillohet në Kralëvë të Serbisë, duke dhënë kohën 16'07"93, ndërsa rivalet i la

shumë prapa. Të shtunën Gega fitoi dy herë. Ajo njëkohësisht u shpall kampione e Ballkanit në garën e saj të preferuar të 3 000 metrave me pengesa dhe siguroi formalisht kualifikimin për në Lojërat Olimpikë. Koha ishte 9'21"53,

ndërsa norma olimpikë është deri në 9'23". Formalisht kualifikimi u arrit sepse periudha e vendosur nga Federata Botërore e Atletikës nisi më 1 korrik, dhe gara në Kampionatin Ballkanik ishte e para për Luizën që nga ajo kohë.



Al Hilali, ofertë rekorde për Mbappen

PARIS, 24 KORRIK - Vazhdon të jetë e paqartë e ardhmja e Kylian Mbappes i cili ka kërkuar largimin nga Paris Saint Germaini. Real Madridi mbetet favoriti kryesor për të nënshkruar me francezin, por një tjetër klub ka bërë ofertën e parë zyrtare në drejtim të kampionëve në fuqi të Francës. Skuadra arabe Al Hilali ka paraqitur ofertën zyrtare për t'i fituar shërbimet e Mbappes dhe bëhet fjalë për një ofertë që është rekord botëror. Al Hilali i ka ofruar PSG-së 300 milionë euro dhe nëse pranohet kjo ofertë atëherë do të thuhet rekordi botëror i transferimeve i cili mbahet nga Neymar me 222 milionë euro. Ndërkohë lojtarin e pret një kontratë pesëvjeçare nga e cila do të fitojë 400 milionë euro në sezon, ku Mbappe do të bëhet futbollisti më i paguar në histori të futbollit. Mbetet të shihet nëse 24-vjeçari do të pranojë një lëvizje shokuase në drejtim të kampionatit arab, ku tanimë shumë yje kanë zgjedhur milionat para karrierës në ligat më të forta evropiane. Mediet e



ndryshme evropiane kanë raportuar se Al Hilali është e gatshme t'i lejojë edhe një klauzolë largimi pas një viti Mbappes për t'u transferuar në Real Madrid.

PSG-ja pëlqen ta shesë Mbappen në Barcelonë dhe jo në Real

"Telenovela" Kylian Mbappe nuk ka fund. Gazeta franceze "L'Equipe" raporton se FC

Barcelona dhe Paris Saint Germain do të takohen për ta vlerësuar transferimin e Mbappes në Barcelonë. Besohet se drejtuesit e PSG-së nuk janë të interesuar ta lejojnë yllin e saj të transferohet në Real Madrid. Megjithatë, ende nuk dihet nëse ylli francez dëshiron të kalojë te Barcelona, pasi ai në letërën e fundit dërguar PSG-së pohonte se do të përmbushte edhe një vit kontratë në Paris madje, siç thonë burime pranë tij, edhe sikur të qëndronte në tribunë.

Gjest i madh nga Galatasaray, blen kartonin e Icardit dhe e lejon të shkojë në Argjentinë

STAMBOLL, 24 KORRIK - Skuadra e Galatasarayt e bleu kartonin e sulmuesit argjentinas Mauro Icardi nga PSG-ja për vlerën e 10 milionë eurove. Për sulmuesin 30-vjeçar një kontratë trevjeçare deri në vitin 2026. Gjithsesi, Icardi nuk do ta veshë fanellën e Galatasarayt në shtator. Për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore të bashkëshortes së tij Wanda Nara (është edhe agjentja e tij), sulmuesi do të shkojë në Argjentinë për t'i qëndruar pranë. Për këtë arsye, Icardi do të huazohet për 6 muaj te skuadra e Newell Old Boys, në qytetin e Rosario (Argjentinë), ku dhe ndodhet e shtruar në spital bashkëshortja e tij. Ende nuk dihet sëmundja e Wanda Naras, por ajo do të ketë pranë bashkëshortin në këtë moment të vështirë. Icardi do të stërvitet dhe



të luajë me Newell Old Boys, ndërkohë që zyrtarizimi do të bëhet ditët në vijim. Gjithçka do të varet edhe nga diagnoza që do

ta japin mjekët. Sezonin e fundit Icardi realizoi 22 gola e 8 asistime në 24 ndeshje në kampionatin turk.

SHKURT

Lecce ofron një milion euro për Ramadanin

Pas zërave për interesin e Lecces për shërbimet e Ylber Ramadanit, tashmë ka ardhur edhe oferta zyrtare e klubit italian. Sipas "Sky Sport", skuadra nga Salento paraqiti tek Aberdini ofertën me vlerë një milion euro për blerjen e kartonit të futbollistit shqiptar. Kuqeziu cilësohet përforcim mjaft i rëndësishëm në mesfushë për sezonin e ri të Serisë A italiane. Sezonin e kaluar, Ramadan luajti 32 ndeshje në Premierë Ligën skoceze, ku realizoi edhe një gol. Ai është kthyer në një prej lojtarëve më të rëndësishëm edhe në Kombëtaren e drejtuar nga trajneri Sylvinho.

Ronaldo: Shpresojmë t'i fitojmë të gjithë trofetë

Cristiano Ronaldo pret t'i fitojë të gjithë trofetë e mundshëm sezonin e ardhshëm. Ylli portugez foli nga Japonia, atje ku po kryen turneun para-sezonal me Al-Nassr. "Shpresojmë t'i fitojmë të gjithë trofetë. E dimë se do të jetë shumë e vështirë, por kemi një skuadër të mirë, një trajner të ri dhe lojtarë të rinj", ka thënë Ronaldo. Ekipi saudit sezonin e ardhshëm do të drejtohet nga Luis Castro. "Ambiciet janë të njëjta me vitin e kaluar. Ne duam të kemi një sezon të mirë dhe unë dua të fitoj disa trofe këtë vit. Të shohim se çfarë do të ndodhë", ka shtuar 38-vjeçari. Kujtojmë se në sezonin e fundit Al-Nassri nuk e fitoi asnjë trofe.

Anelotti: Bellingham luajti mirë, ka cilësi të jashtëzakonshme

Jude Bellingham debutoi për Real Madridin në fitoren 3-2 ndaj Milanit. Reali pagoi 100 milionë euro për t'i marrë shërbimet e yllit anglez nga Borussia Dortmundi. Pas ndeshjes, trajneri Carlo Ancelotti e ka lavdëruar transferimin e rëndësishëm të skuadrës së tij. "Bellinghami ka luajtur një lojë të mirë dhe skuadra duhet të mësohet me cilësinë e tij, të cilat janë të jashtëzakonshme. Vrapimet e Jude në zonë janë shumë të rëndësishme për ekipin. Më pëlqen sistemi, por ne kemi parë disa fusha për t'u përmirësuar", ka thënë Ancelotti.

Sabitzer pritet t'i bashkohet Dortmundit

Mesfushori 29-vjeçar austriak Marcel Sabitzer do të luajë me ekipin e Borussia Dortmundit sezonin tjetër. Sipas medieve gjermane, skuadra e Bayern Munchen ka rënë dakord si me lojtarin ashtu dhe me Dortmundin për transferimin e Sabitzerit për vlerën e 20 milionë eurove. Edhe muajt e fundit të sezonit të kaluar mesfushori luajti larg Munchenit, pasi Bayerni e huazoi te Manchester Unitedi. Trajneri Thomas Tuchel dhe skuadra bavareze nuk e konsiderojnë Sabitzerin të rëndësishëm në planet e tyre, ndaj kanë vendosur ta shesin. Ky është një transferim përfundimtar për Sabitzerin, që asnjëherë nuk pati një marrëdhënie të mirë me "bavarezët", ekip ku erdhi në vitin 2021 (54 ndeshje dhe 2 gola). Te Borussia e konsiderojnë një transferim me vlerë, pasi besojnë te përvoja e lojtarit austriak.

Dembele refuzon ofertën prej 200 milionë eurosh nga Arabia Saudite

Mediet spanjolle dhe ato franceze kanë bërë me dije se sulmuesi i krahut i Barcelonës, Osman Dembele, ka refuzuar një ofertë marramendëse nga Arabia Saudite. Portali "Footmercato" ka zbuluar se

Al-Nasri i Cristiano Ronaldos ka zbarkuar në Barcelonë për t'i paraqitur lojtarit të Barçës një kontratë vjetore prej 40 milionë eurosh për secilin nga pesë sezonet e ardhshme. Sipas të njëjtit portal,

operacioni do të ishte me një vlerë mbi 250 milionë, sepse klubi saudit mori përsipër edhe 50 milionë eurot që figurojnë në kontratën e Dembelesë si klauzolë përfundimi këtë korrik. Por sipas "Footmercato",

lojtari do të kishte refuzuar këtë ofertë të majme sepse interesi i tij është të qëndrojë te Barça. Ai tashmë i ka shpjeguar klubit se synimi i tij është të vazhdojë, teksa palët kanë nisur bisedimet për një rinovim të

mundshëm të kontratës së tij me klubin "blaugrana". Al-Nasri ka investuar tashmë në këtë fushatë merkatoje duke afuar në ekip Seko Fofanën dhe Marcelo Brozoviçin, i pari nga Lensi, i dyti nga Interi.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 23.06.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhëshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 25.07.2023 të shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e për projektim, zhvillim dhe inkasim - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 06-23-34

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe mbikqyr procesin e punës në shërbimin me klient në funksion të inkasimit efektiv të faturave për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- Harton planin dhe programin e punës mbi aktivitete në arritjen maksimale të shkallës së inkasimit dhe regjistrimit të çdo konsumatori.
- Mbikqyr punën e koordinon punën e inkasimit dhe raportet e punës së tyre.
- Përgjigjet në ankesat e konsumatorëve dhe ndërmer veprimet e nevojshme për realizimin e kërkesave sipas vërejtjeve lidhur me kualitetin e shërbimeve.
- Pjesëmarrja në përpilimin, projektimin dhe kordinimin e planeve dhe përgjegjësia për zbatimin e tyre.
- Përgatit kontratat me konsumatorët dhe mban evidencën e tyre me të gjitha elementet e nevojshme.
- Kujdeset për zbatimin e Kartës së konsumatorëve dhe bashkëpunon me udhëheqësin operativën në funksion të inkasimit sa më të lartë,
- I raporton Zyrtarit të lartë financiar për të gjitha qështjet relevante financiare nga Shërbimi me klient në bazë të raportit mujor, mbi ndryshimet financiare dhe harmonizimin e kontratave për shërbimet me tarifat në fuqi.
- Për çdo kontratë për shërbime, një kopje ia dorëzon udhëheqësit të operativës duke njoftuar atë për çdo ndryshim eventual të pastajshëm mbi kushtet nga kontrata bazë. Për vërejtjet e konsumatorëve në lidhje me shërbimet, me kohë e njofton me shkrim udhëheqësin e operativës.
- Paraqet raporte mujore mbi kërkesat dhe punë me konsumator-klijent. Kryen edhe punë tjera sipas urdhërimit të eprorit të drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- CV-në
- Të ketë Diplomë të fakultetit Ekonomik, Juridik ose të ngjajshme;
- Aftësi organizative, planifikuese dhe kordinuese;
- Preferohet njohja e gjuhëve të huaja;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.
 Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 25.07.2023 deri më datën 08.08.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 23.06.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhëshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 25.07.2023 të shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës:

Recepionist/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 06-23-34/2

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Pranon palët dhe informon personelin me palët;
- Në koordinim me personel përcjell palën deri tek personeli;
- Vendos, përcjell dhe tërheq listën e nënshkrimeve për vajtje ardhje në punë për personel;
- Evidenton palën në evidencën e tyre dhe mban evidencë të palëve;
- Është përgjegjës për siguri të personelit brenda orarit të punës;
- Kryen detyra tjera të caktuara nga Menaxheri i Sektorit;
- Për punën e sektorit harton raporte të rregullta dhe periodike;
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në përgjigjet udhëheqësit drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.
 Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 25.07.2023 deri më datën 08.08.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 23.06.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhëshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 25.07.2023 të shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës:

Inkasant/e - Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 06-23-34/1

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bënë zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të paregjistruara;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorëzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materjale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.
 Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 25.07.2023 deri më datën 08.08.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Law Firm Consulting E Hoti" L.L.C., emri tregtar Avokate Emine Hoti me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811497769 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Law Firm Consulting E Hoti" L.L.C., trgovacko ime, Avokate Emine Hoti od Gnjilana, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811497769 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Law Firm Consulting E Hoti" L.L.C., commercial name, Avokate Emine Hoti with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811497769 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Ofertë për shitjen e Patundshmërisë

Nashide (Shaban) Kadriaj, me adrese banimi në Prizren, Rr. "Rexhep Kabashi" Hyrja 1/41, është bashkëpronar - e të patundshmërisë, me sa vijon: Me pjesën prej 10/108 e pjesës ideale (rreth 1000m²) të ngastrës kadastrale nr-P-71813068-05471-4, në vendin e quajtur "Levishko pole" me kulturë bujqësore - are e kl .3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 10330 m², ZK.Prizren.

Shitësi- ja, Nashide (Shaban) Kadriaj nga pjesa e vet ideale të patundshmërisë P.nr,05471-4 ofertën për shitje, sipërfaqen e përgjithshme prej 364 m² të patundshmërisë me të dhënat si më lartë, në shumën e përgjithshme prej 9.670 €uro (me shkronja : Nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë euro).

Prizren, 12.07.2023

Ofertuesi- ja,

Nashide (Shaban) Kadriaj.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Eliza Frrokaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën nga klasa -VI-IX-, të lëshuar nga SH.M.U "Emin Duraku", Gjakova.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L